



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës 1Nr.020-319 i datës 31.03.2010, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për hartimin e Projekt-Vendimit të ri për strukturën organizative të administratës së Komunës (Organogrami), në këtë përbërje:

1. Xhevahire Zeqiri, Udhëheqëse e Personelit, Kryesuese
2. Shemsi Azemi, Shef i Sektorit për Tatim Pronë, anëtar
3. Islam Kaleshi, Zyrtar ligjor në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që konform dispozitave ligjore në fuqi të hartoj Projektin e ri të Strukturës organizative të administratës së Komunës (Organogramin).

Detyrat e cekura Komisioni do ti kryej më së largu me datë 06.12.2021 duke i prezentuar me shkrim Kryetarit të Komunës Projekt-Vendimin e cekur.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesia dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020-71831
Lipjan, më 17.11.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

